R E P U B L I K A E S H Q I P Ë R I S Ë
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK

PROCESVERBAL

Nr. 6, datë 16.09.2026

I mbledhjes së Këshillit Bashkiak Durrës që zhvillohet në sallën e Këshillit Bashkiak

Orari i fillimit të mbledhjes : 11:10
Data e mbajtjes së mbledhjes : 16.09.2026
Mbajtja e mbledhjes : Salla e Këshillit Bashkiak
Lloji i Mbledhjes: Mbledhje e Radhës

Përfaqësuesit e Bashkisë Durrës: Kryetarja e Bashkisë znj. Emiriana Sako si dhe përfaqësues të drejtorive, që kanë përgatitur materialet për mbledhjen plenare.

Denisa Luarasi: Mirëdita!
Të nderuar këshilltarë !E nderuar kryetare ! Të nderuar të pranishëm! Ju përshëndes dhe ju uroj mirëseardhjen në mbledhjen e parë të këtij sesioni të ri të punës së Këshillit Bashkiak.
Deklaroj të hapur këtë mbledhje të radhës për këshillin tonë bashkiak. Ku në këtë mbledhje do të shqyrtojmë dhe do të miratojmë 9 projektvendime të propozuara nga kryetarja e bashkisë. Materialet ju janë vënë në dispozicion nga Sekretariati. Ftoj Dorin të bëj apelin.

Dorina Milja: Përshëndetje!
Fillojmë ng apeli...
Ardian Muka ... ……deri tek…. Florian Tahiri…
39 këshilltarë në sallë.
V.O (Largohen tek pika 1 e rendit të ditës këshilltarët Dritan Burgija dhe Arlind Boshku, tek pika 8 largohet Zhuljeta Ngota).

Denisa Luarasi: Faleminderit Dori.
Meqë kuorumi është i pranishëm, vazhdojmë me mbledhjen.
Po Flutura.

Flutura Kasa : Dëgjohem tani ?
Kam dhe zërin e lartë dhe s'është shumë problem.
Vetëm 2 sekonda një falenderim për gjithë këshilltarët këtu për mbështetjen që bënë për aktivitetin për fëmijët jetim dhe fëmijët në nevojë. Një falenderim zemre ndoshta njerëzit mund ta quajnë diçka të vogël, por për mua ishte diçka shumë e madhe, sepse të gëzosh zemrat e 74 fëmijëve, nuk është gjë e vogël. Kështu që ju falenderoj gjithë këshilltarëve. Dhe më në fund na pa njëherë populli bashkë, larg ngjyrave politike, që ta kuptojnë që ne përplasjet ideve dhe mendimeve i kemi vetëm këtu, ndërsa jashtë jemi miq. Faleminderit për mbështetjen.

Denisa Luarasi: Faleminderit Flutura që u bëre nismëtare e këtij aktiviteti shumë të bukur.
Vazhdojmë me leximin e rendit të ditës.

Pika 1.	PËR MIRATIMIN E FAMILJEVE PËRFITUESE TË NDIHMËS EKONOMIKE NGA FONDI I KUSHTËZUAR PËR BLLOK-NDIHMËN EKONOMIKE DERI 6% DHE FONDI I TË ARDHURAVE TË BASHKISË DURRËS, PËR MUAJIN GUSHT 2026
Pika 2.	PËR KORRIGJIMIN E GABIMIT MATERIAL NË VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK NR. 48, DATË 09.07.2026 PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE TË VLERËSIMIT DHE TRAJTIMIT FINANCIAR PËR SPORTISTËT DHE TRAJNERËT QË PËRFAQËSOJNË QYTETIN E DURRËSIT NË KOMPETICIONE KOMBËTARE DHE NDËRKOMBËTARE PËR VITIN 2026
Pika 3.	PËR MIRATIMIN E PLANIT TË INTEGRITETIT PËR BASHKINË DURRËS PËR VITET 2026-2028
Pika 4.	PËR MIRATIMIN E PËRDORIMIT TË FONDIT TË ALOKUAR NË ZBATIM TË VKM-SË NR. 624, DATË 30.07.2026 "PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE DHE SHKËMBIMIN E PRONËS NË FUNKSION TË PROCESIT TË RINDËRTIMIT, NË ZONËN E RE PËR ZHVILLIM NË SPITALLË, BASHKIA DURRËS "RIKONSTRUKSION I RRUGËVE "MIQËSIA" DHE "AZEM HAJDARI", LOTI III, RRUGA "AZEM HAJDARI", LOTI IV, RRUGA "VALA E DETIT"
Pika 5.	PËR MIRATIMIN E FONDEVE TË ALOKUARA NGA BUXHETI I SHTETIT NË ZBATIM TË AKTIT NORMATIV NR.2, DATË 30.06.2026 "PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN 87/2025, "PËR BUXHETIN E VITIT 2026"

Pika 6.	PËR MIRATIMIN E FAMILJEVE PËRFITUESE TË NDIHMËS EKONOMIKE NGA FONDI I KUSHTËZUAR PËR BLLOK-NDIHMËN EKONOMIKE DERI 6 % DHE FONDI I TË ARDHURAVE TË BASHKISË DURRËS, PËR MUAJIN SHTATOR 2026
Pika 7.	PËR MIRATIMIN E NJË SHTESË TË NUMRIT TË PUNONJËSVE TË DREJTORISË SË POLICISË BASHKIAKE, DURRËS
Pika 8.	PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VKB-NË NR.66, DATË 25.06.2024 "PËR PËRCAKTIMIN E ZONAVE TË ADMINISTRIMIT TË PARKIMIT DHE TARIFAVE TË SHËRBIMIT TË PARKIMIT ME PAGESË NË RRUGË DHE SHESHE NË TERRITORIN E BASHKISË DURRËS", I NDRYSHUAR
Pika 9 dhe e fundit	PËR NDRYSHIME NË VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK NË NR. 73, DATË 23.12.2025 "PËR MIRATIMIN E BUXHETIT TË BASHKISË DURRËS PËR VITIN 2026 DHE PROGRAMIN BUXHETOR AFATMESËM 2026-2028" DHE VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK NR.32, DATË 12.06.2026 "PËR MIRATIMIN E PËRDORIMIT TË FONDEVE TË TRASHËGUARA NGA VITI 2025

Keni ndonjë koment?
Jeni dakort me rendin e ditës?
Kalojmë në votim elektronik.
Me 39 vota pro miratohet rendi i ditës i pa ndryshuar.

- I jepet fjala për projekt-vendimin **e pikës 1,** Komisionit të Rregullores dhe Çështjeve Juridike, zonjës Joniada Musaraj.

Joniada Musaraj: Atëherë, përshëndetje të gjithëve.
Komisioni ynë pikën e parë e miratoi me shumicën e votave dhe fton këshillin që të japi votën pro, sot. Faleminderit.

Denisa Luarasi: Faleminderit, zonja Musaraj.
Komisioni i Barazisë Gjinore, Mirëqenies Sociale dhe Mosdiskriminimit, z.Florian Tahiri.

Florian Tahiri: Përshëndetje !
Si gjithmonë përsa i përket miratimit të familjeve përfituese të ndihmës, ne e miratuam pro në unanimitet si gjithmonë. Faleminderit.

Denisa Luarasi: Faleminderit, z.Tahiri.
Komente, pyetje kemi për pikën 1 të rendit të ditës? ....
Po, po Burgija.
Ndoshta nuk ke klikuar 5-n.

Dritan Burgija: Ta marr unë fjalën i pari, se kohën e kam të limituar, dhe nuk është se do merrem me votimin e gjithë pikave të rendit të ditës.
Kam një përmbledhje të shkurtër 5 minuta, përsa i përket aktivitetit.

Ka mundësi?

Denisa Luarasi: Kujt aktivitet?

Dritan Burgija: Aktivitetit të këshillit.

Denisa Luarasi: Jemi te pika e parë e rendit të ditës.

Dritan Burgija: Jemi tek pika 1 e rendit të ditës, por nëse do fillojmë me votu, i bie që…..

Denisa Luarasi: Okej. Të paktën koncentroje, jo 5 minuta.

Dritan Burgija: 5 minuta, se unë e kam të përgatitur.

Denisa Luarasi: Okej, dakord.

Dritan Burgija: Përshëndetje të gjithëve, njëherë.
Të nderuar kolegë , të nderuar qytetarë të Durrësit.
Edhe rendi i sotëm i ditës na kthen te disa nga çështjet për të cilat kam folur vazhdimisht edhe më parë.
Së pari: Kam kundërshtuar disa herë mënyrën se si pika të rendit të ditës janë sjellë në momentin e fundit. Kjo mund të duket teknike, por nuk është. Nëse një këshilltari i jep materialin pak orë përpara mbledhjes dhe pastaj i kërkon të votojë, po i kërkon praktikisht të votojë pa e kontrolluar. Unë nuk mund ta bëj këtë.
Dua të jem në gjendje t'i them qytetarit: E lexova. E kontrollova. Pyeta. Mora përgjigjen. Pastaj votova. Kjo është përgjegjësi për mu.
Së dyti: Po ndryshojmë përsëri buxhetin. Fonde të parashikuara për disa investime – 20 milionë lekë për skulptura në qytet, por edhe për projektin e bibliotekës, shkollën e mesme, pajisjet e çerdhes dhe sinjalistikën turistike – hiqen nga lista dhe, bashkë me një pjesë të fondit rezervë, kalojnë për riforcimin e dy pallateve të dëmtuara nga tërmeti. Siguria e banorëve është prioritet sigurisht dhe për këtë nuk ka diskutim. Por kjo na kthen përsëri te ajo që kam kërkuar prej vitesh: buxheti duhet të ketë prioritete të qarta dhe planifikim serioz. Sepse kur brenda të njëjtit vit heqim para nga një projekt për të mbuluar një nevojë më urgjente, është normale të pyesim : Pse prioritetet nuk janë vendosur siç duhet që në fillim?
Së treti: Parkimi dhe propozimi për shtimin me 20 punonjës të Policisë Bashkiake lidhen drejtpërdrejt me shërbimin që qytetari merr dhe me koston që përballon. Në dokumentacion janë shtuar edhe hartat e hapësirave publike të zonave A dhe B, me një shtrirje të konsiderueshme dhe me dhjetëra pika konkrete në qytet. Kur flasim për një skemë me këtë përmasë, bëhet edhe më e rëndësishme ajo që kam kërkuar më parë: të dimë qartë jo vetëm ku dhe sa do të paguajë qytetari, por çfarë shërbimi real do të marrë në këmbim. Vetë relacioni e lidh shtimin e personelit edhe me kontrollin e zonave të parkimit me pagesë, masat administrative dhe gjobat, prandaj edhe këtu pyetja ime mbetet e njëjtë: kur qytetarit i shtojmë tarifë, kontroll apo kosto publike, a po i japim në të njëjtën masë një shërbim më të mirë?

Dhe pikërisht, këto pika të sotme nuk janë të shkëputura nga diskutimet që kemi bërë gjatë gjithë mandatit. Janë po ato çështje: buxheti, rindërtimi, tarifat, shërbimet dhe përgjegjësia ndaj qytetarit. Prandaj dua ta lidh diskutimin e sotëm me mënyrën se si e kam kuptuar dhe ushtruar mandatin tim në këtë Këshill.
Gjatë këtyre viteve kam votuar pro, kam votuar kundër, kam abstenuar, kam kërkuar informacion, kam kundërshtuar procedura, kam ngritur probleme…
Dhe të gjitha këto kanë një emërues të përbashkët: votën që më kanë dhënë qytetarët nuk e konsideroj pronën time dhe aq më pak pronën e dikujt tjetër. Unë jam në këtë sallë, sepse qytetarët më kanë votuar që t'i përfaqësoj ata. Jam këtu për të lexuar, për të pyetur, për të kontrolluar dhe pastaj për të marrë përgjegjësinë e votës sime.
Një nga çështjet ku kam insistuar më shumë ka qenë rindërtimi.
Që në fillim kam kërkuar informacion mbi familjet që prisnin zgjidhje, bonusin e qirasë, fondet, kriteret e përfitimit dhe ndryshimet e vazhdueshme në listat e përfituesve. Kam kërkuar edhe ngritjen e një Komisioni Hetimor të Këshillit për përdorimin e fondeve dhe kriteret e përzgjedhjes së përfituesve. Kam kërkuar dokumente dhe përgjigje. Dhe sot vazhdoj ta shoh rindërtimin me të njëjtën logjikë. Rindërtimi nuk përfundon kur mbyllet një procedurë administrative.
Kam kundërshtuar përjashtimin e qytetarëve nga skema pas shumë vitesh proces. Por kam votuar pro kur një ndryshim konkret u jepte zgjidhje familjeve. Sepse qytetari nuk duhet të paguajë çmimin e konfliktit politik.
Kam folur vazhdimisht për ndihmën ekonomike. Dhe fakti që një familje aplikon për një shumë kaq të vogël duhet të na bëjë të mendojmë shumë përpara se ta trajtojmë varfërinë si një kolonë në një tabelë.
Kam pyetur për indeksimin e ndihmës. Kam pyetur për kriteret. Kam pyetur për mënyrën e vlerësimit të familjeve. Kam ngritur çështjen e familjeve rome.
Ndihma ekonomike nuk duhet të perceptohet kurrë si mirësi e pushtetit. Ajo është përgjegjësi sociale. Varfëria nuk ka parti. Nevoja nuk pyet se për kë ke votuar.
Kam kundërshtuar rritje apo vendosje tarifash kur nuk jam bindur se qytetari po merr në këmbim një shërbim proporcional.
Kur është diskutuar uji, kam pyetur: sa qytetarë e marrin realisht shërbimin që paguajnë?

Denisa Luarasi: Burgija, kaloj 5 minuta, pak shpejtë.

Dritan Burgija: Të lutem tashi, unë....
Zonja Kryetare, të lutem mos ma ndërprit mendimin, se kam nja 3 muaj…..

Denisa Luarasi: Ti e ke të shkruar, pak më shpejt të lutem.

Dritan Burgija: Po mirë, se e mbarojmë, mos u mërzit.
Tashi po e thashë shpejt e shpejt , as ju s'do kuptoni gjë.
Nëse familjet..... okej.
Për parkimet kam mbajtur të njëjtin qëndrim. Problemi ekziston. Por nuk mund të ndodhë që sa herë administrata përballet me një problem, përgjigjja më e shpejtë të jetë një faturë e re për qytetarin.

Kam kërkuar alternativa. Kam kërkuar trajtim të drejtë për rezidentët. Kam kërkuar që efekti financiar mbi familjet të merret seriozisht në konsideratë.
Qytetari nuk është një burim i pafund të ardhurash për administratën. Ai paguan taksa dhe tarifa që të marrë shërbim.
Kam insistuar shumë te buxheti, sepse buxheti është vendi ku fjalët politike marrin vlerë reale. Mund të flasim pafund për prioritetet. Por më tregoni ku shkojnë paratë dhe do t'ju tregoj se cilat janë prioritetet e vërteta.
Kur kam parë diferenca të mëdha ndërmjet investimeve të planifikuara në vite të ndryshme, kam pyetur: pse? Kur kam parë rrugë, rehabilitime lagjesh, sheshe apo investime të tjera të shtyhen per një vit tjetër, kam kërkuar shpjegim.
Që në vitin 2023 kam ngritur problemin e shpërndarjes së investimeve ndërmjet viteve dhe kam kërkuar që qytetarëve t'u shërbehet me intensitet gjatë gjithë mandatit. E kam ngritur përsëri këtë çështje në diskutimin e buxhetit të vitit 2026. Sepse një qytetar që ka rrugën e dëmtuar sot,një lagje që përmbytet sot nuk mund të presë kalendarin politik. Qytetari duhet të jetë prioritet katër vjet. Jo vetëm kur vota e tij bëhet më e rëndësishme.
Kam folur për turizmin. Nuk mund të vazhdojmë ta konsiderojmë Durrësin vetëm destinacion të korrikut dhe gushtit. Ky qytet ka histori, kulturë, arkeologji, det dhe një pozicion që duhet ta bëjë qytet të vizitueshëm dymbëdhjetë muaj të vitit.
Kam mbajtur qëndrim të fortë për pronën. Sepse prona e një qytetari nuk është një numër në një relacion. Është puna dhe kursimi i një jete.
Kur kam parë vlerësime shpronësimi qesharake kam kërkuar shpjegime. Kam ngritur konkretisht pyetjen : se si mund të ulet vlera e kompensimit në një kohë kur vlera e tregut në qytet është në rritje?
Një projekt publik mund të jetë shumë i rëndësishëm. Por interesi publik nuk mund të ndërtohet duke prodhuar me arrogance një padrejtësi individuale.
Këtë e kam mbrojtur edhe në çështjet ku banorët janë prekur drejtpërdrejt nga projekte të mëdha.
Kam kërkuar që përfaqësuesit e tyre të dëgjohen në sallë. Sepse nuk mund të diskutojmë për shtëpinë e dikujt dhe ta lëmë pronarin e shtëpisë jashtë derës. Nuk mund të themi se vendosim në emër të qytetarëve dhe pastaj të kemi problem kur qytetari kërkon të flasë vetë.
Këtu dua të ndalem pak te një çështje që për mua lidhet me punën në Këshill, por shkon përtej tij.

Denisa Luarasi: Të kishe thënë 10 minuta, jo 5 minuta Burgija. Të lutem tashi.

Dritan Burgija: Edhe 2 paragrafe janë dhe jeni të qetë pastaj.

Denisa Luarasi: Po, jo më jo , të qetë jemi dhe tani ne.

Dritan Burgija: Prit njëherë, se mund ta ndaja dhe mas çdo pike.

Denisa Luarasi: Okej.

Dritan Burgija: Pse doni gjithmonë, ta prishni?

Denisa Luarasi: Të lutem Burgija mos...
Vazhdo...

Dritan Burgija: Po thoja, po dal në çështje që lidhen me punën në këshill, por shkon përtej tij. Kam bindjet e mia politike. Kam një histori politike. Kam mbështetur vendime kur kam besuar se ishin të drejta dhe kam kundërshtuar vendime kur kam menduar se cenonin parime, që i konsideroj të rëndësishme.

…..*Flasin në sallë njëkohësisht*.....

Dritan Burgija: Ka mundësi.....
Dhe këtë nuk e kam bërë vetëm sot.
Unë nuk besoj në politikën ku drejtuesi është gjithmonë më i rëndësishëm se parimi. Nuk besoj në politikën ku funksioni është më i rëndësishëm se dinjiteti. Dhe nuk besoj në politikën ku për të mbajtur një pozicion duhet të dorëzosh mendimin tënd. Sepse sot mund të kesh një funksion. Nesër mund të mos e kesh. Sot mund të jesh pranë drejtimit. Nesër mund të mos jesh. Por nëse gjatë kësaj rruge ke ndryshuar standardin sa herë ndryshon interesi yt, atëherë nuk ke pasur standard. Ke pasur vetëm interes.
Së fundmi, duhet ta mbyll:
Mandati im buron nga vota e qytetarëve dhe do vazhdoj ta përdor atë në shërbim të tyre edhe kur dy parti ortake bëhen bashkë për të na mbyllur gojën.
Faleminderit.

Denisa Luarasi: Faleminderit Burgija.
Atëherë kalojmë në votim elektronik për pikën e parë të rendit të ditës.

Ardian Muka: Jo, kam një replikë

Denisa Luarasi: Jo të lutem nuk u përmende fare.

Ardian Muka: Në emër të grupit.....

Denisa Luarasi: Kalojmë në votim.
Me 36 vota pro dhe 1 abstenim miratohet pika 1 e rendit të ditës.

- I jepet fjala për projekt-vendimin **e pikës 2** Komisionit të Rregullores dhe Çështjeve Juridike, zonjës Joniada Musaraj.

Joniada Musaraj: Atëherë, edhe për pikën e dytë kryetare ne e votuam dhe ftojmë këshillin që ta miratoj sot. Faleminderit.

Denisa Luarasi: Faleminderit, zonja Musaraj.
Komisioni i Kulturës, Arsimit, Rinisë, Sporteve, Komuniteteve Fetare dhe Titujve të Nderit z.Kastriot Xhongoli.

Kastriot Xhongoli: Përshëndetje të gjithëve!
Edhe komisioni jonë ra dakort që kjo pikë te kaloj sot në mbledhjen e rendit të ditës. Faleminderit.

Denisa Luarasi: Faleminderit, zoti Xhongoli.
Komente, pyetje ka për pikën 2 të rendit të ditës?.....
Nuk ka. Kalojmë në votim....
Me 36 vota pro dhe 1 kundër miratohet edhe pika 2 e rendit të ditës.

- I jepet fjala për projekt-vendimin **e pikës 3** Komisionit të Rregullores dhe Çështjeve Juridike, zonjës Joniada Musaraj.

Joniada Musaraj: Atëherë, edhe për pikën e tretë kryetare ne e votuam dhe ftojmë Këshillin që ta miratoj sot. Faleminderit.

Denisa Luarasi: Shumë faleminderit, zonja Musaraj.
Komisioni i Etikës, Apelimeve, Konfliktit të Interesit, Peticioneve, znj. Anisa Ibraj.

Anisa Ibraj: Dhe komisioni jonë u mblodh dhe vendosëm që ta kalojmë për votim sot në mbledhjen e Këshillit Bashkiak. Faleminderit.

Denisa Luarasi: Shumë faleminderit znj Ibraj.
Komente, pyetje ka për pikën 3 të rendit të ditës?.....
Po Muka.

Ardian Muka: Me thënë të drejtën, kisha një pyetje përpara, që do të kërkoja një përgjigje pastaj nga ana e stafit të bashkisë, meqë nuk jemi pjesë e komisionit.
Kur flitet në pjesën "Zhvillimi dhe konsolidimi i sistemit të menaxhimit të burimeve njerëzore", pika 2 është, pra, në funksion të forcimit të marrëdhënieve të mekanizmave të integritetit institucional dhe, duke marrë në konsideratë gjetjet e evidentuar gjatë Planit të Integrimit 21-24, dokumenti parashikon masat e mëposhtme, të organizuara në 3 objektiva strategjikë. Ke pika 2 flitet për "Zhvillimin dhe konsolidimin e sistemit të menaxhimit të burimeve njerëzore, me fokus rritjen e kapaciteteve të administratës në fushën e sinjalizimit, mbrojtjes së sinjalizuesve, si dhe sistemin HRMIS". Ka mundësi të na e shpjegojë dikush?
Pastaj kam dhe koment gjithmonë për pikën, por doja një shpjegim se për çfarë flitet: sinjalizimi, sinjalizuesi dhe këtë sistemin HRMIS.

Denisa Luarasi: Po, po, zoti Muka.
Ftojmë administratën.

Brunilda Gripshi (*drejtoresh e DBNJ***):** Atëherë, ligji për sinjalizuesit është ligji, që prek sektorin e auditit të brendshëm në institucionin e bashkisë. Çdo institucion është i detyruar që të ketë një njësi të tillë. Njësia, e cila duhet të jetë bërë e ditur të gjithë punonjësve, patjetër që mirëpret edhe çdo ankesë që mund të bëhet. Funksionon si një "black box", praktikisht, ka një kuadër ligjor të cilin duhet ta zbatojnë dhe të përmbushë të gjitha detyrimet ligjore si sinjalizues.

Denisa Luarasi: Faleminderit, drejtoresha.

Brunilda Gripshi: Pra, prek njësinë e auditit të brendshëm në institucion.

Ardian Muka: Sistemi kujt i rferohet HRMIS?

Brunilda Gripshi: HRMIS-i është një sistem i brendshëm që është i miratuar nga Departamenti i Administratës Publike dhe është sistemi elektronik i menaxhimit të punonjësve. Jemi ende në bashkëpunim me IDS-në, një projekt që ka nisur për të paraqitur në mënyrë elektronike të gjitha dosjet e personelit. Aktualisht, aksesin në këtë sistem e kanë vetëm Burimet Njerëzore, të cilët, siç thashë, po bashkëpunojnë me Departamentin e Administratës Publike, në një projekt së bashku me IDS-në, për të përmirësuar në mënyrë elektronike këtë sistem, por është ende në proces.

Denisa Luarasi: Faleminderit, drejtoresha. Është e qartë.
Atëherë kalojmë në votim.

Ardian Muka: Kam dhe një koment e thashë shparë.
Pra, kur flasim për shqyrtimin dhe miratimin e "Planit të Integritetit të Bashkisë 26-28", vitet, kemi parasysh se kemi një plan 21-24, i cili, sipas raportit që ju na keni sjellë, projekt-vendimit, flitet që mund të mbështetet në tre kolona: konsolidimi. E para, konsolidimi i kuadrit të brendshëm, rregullatores strategjik nëpërmjet përditësimit kodit etikës, hartimit të gjurmëve të auditimit dhe miratimit të rregullores për konfliktin e interesit. Duke pasur parasysh që Bashkia e Durrësit, kur flasim për konflikt interesi, është, besoj, te shembujt e këqinj të këtij sektori. Kemi parasysh që kemi pas një kryetar bashkie, i cili e betonoi qytetin e Durrësit në funksion të ndërmarrjeve të tij personale dhe na ka sjellë atë një nga pikat që ne do shqyrtojmë më poshtë.

Denisa Luarasi: Të lutem, Muka, mos dil jashtë.

Ardian Muka: Ka lidhje me integritetin kjo.

Denisa Luarasi: Jo fare, absolutisht, mos na bëj…

Ardian Muka: Ka lidhje me integritetin kjo. Kemi një drejtor sektori që ka lidhje me sektorin e ujërave, sektor strategjik, i cili merrte tendera dhe i jepte familjes së vet, prindërve të tij. Kemi shumë drejtorë, drejtorish, të cilët kanë krijuar ndërmarrje private ……

Denisa Luarasi: Mos na e kthe në kafene, të lutem.

Ardian Muka: ..... dhe detyrojnë njerëzit që të trokasin në dyert e tyre për të marrë shërbim në sektorin shtetëror.
Pika e dytë, sinjalizuesit, e morëm vesh, janë ato spiunet famshëm që i kemi pasur, që ne i kemi ngritur në institucion këtë pjesë, se ky është koncepti që kjo qeveri ka ngritur. Pra, ne do

funksionojmë si shoqëri fuksash, ndërkohë që ne, si forcë politike, kemi tjetër mendim dhe tjetër koncept sesi shoqëria do të funksionojë.
Pika e tretë, përmirësimi i transparencës dhe llogaridhënies publike nëpërmjet përditësimit të programit të transparencës, publikimit të regjistrave të kontratave, të administrimit të pronës, përfshirë në grupe vulnerabël, procese vendimmarrjeje. Dhe, përsa i përket kësaj, kemi parasysh që këtu i mbyllet goja një force politike, e cila kërkon komisione hetimore dhe ne kemi kërkuar të paktën 2 komisione hetimore. Një komision hetimor, përsa i takon rikonstruksionit të tërmetit, ku me forcën e kartonit Partia Socialiste, përfaqësuese në Këshillin Bashkiak, vendosi që ky komision të mos ngrihet. Kemi kërkuar 2 komisione, njëra pas tjetrës, por me detyrim, me forcë…

Denisa Luarasi: Kaloi 3-minutëshi.

Ardian Muka: .....detyruan tërheqjen e firmave nga kërkesa për komisionin hetimor për projektin TID. Dhe ne flasim për një etikë dhe për një integritet të Bashkisë së Durrësit.
Për mua është një dokument bosh, është një dokument, i cili ne do ta votojmë kundër. Është një dokument i cili thashë, ne nuk na duhen thjesht letra, sepse duhet të plotësojnë disa normativa të Komunitetit Europian, por ne duhet të jemi konkretë, sepse jemi në shërbim të bashkisë, në shërbim të qytetarëve. Këshilli është një organ mbikëqyrës për të gjitha problematikat që qytetarët kanë dhe nuk i marrin nëpërmjet bashkisë.

Denisa Luarasi: Faleminderit Zoti Muka.
Po, Joniada.

Joniada Musaraj: Atëherë s'dua të përmend emra, që të mos ketë kolegu të drejtën e replikës. Atëherë, për të gjithë këshilltarët dhe qytetarët e Durrësit, me merak po e kap nga fundi. Kam çështjet e komisioneve hetimore. Dua të sqaroj që kërkesat e kolegëve janë rrëzuar për të ngritur komision hetimor, sepse mungonin elementet esenciale formale, së pari, dhe së dyti, mungonte ajo që kërkohet, baza e provave mbi të cilat ngrihet pretendimi. Kështu që, për këtë, jam e qartë sot dhe do të jem gjithmonë e qartë që do të rrëzohen sa herë të mungojnë këto dy elemente për komisionet hetimore.
Në lidhje me çështjet e votimit kundër, unë jam dakord që kolegu shprehet kundër sot, por jam e bindur që nuk e ndjekin të tjerët nga pas.
Së treti, do të doja të thoja që, nëse kolegu do të kishte në duar prova për cënim të parimit të konfliktit të interesit, respektimit të këtij parimi, jam e bindur që do t'i drejtohej mediave dhe institucioneve përkatëse. Të qenurit drejtues në një nga ndërmarrjet apo institucionet e qarkut të Durrësit nuk i privon të drejtën askujt që të hapë një biznes përsa kohë nuk përfiton nga buxheti i shtetit dhe nuk përfiton të ardhura, para, apo familja e tij që e ka ngritur këtë biznes. Kështu që nuk mundeni ju sot që të pretendoni që, atyre që janë në poste drejtuese t'u privohet një e drejtë që e kanë të gjithë të tjerët, që patjetër e keni dhe ju i pari në Durrës. Unë nuk mendoj që ju jeni privuar nga e drejta për të pasur biznes, ju dhe familjarët tuaj, apo dhe kolegët majtas-djathtas që i keni ku jeni ulur.
Shumë faleminderit.

Denisa Luarasi: Faleminderit, zonja Musaraj.
Atëherë kalojmë në votim. Kush është…?
Po Flutura.

Flutura Kasa: Atëherë, kisha diçka me zotin Muka. Ia kam thënë edhe herë tjetër. Nuk është....
O Denisa, atë që e nis, ti e di që do e çoj deri në fund.
Atëherë, nuk është etike me diskutuar këtu çfarë është bërë dhe këto lidhjet familjare. Këtu flitet për këtë integritet që po votojmë sot. Kështu që flasim për këtë që kemi sot. Dakord? Mos flasim tani. Ka qenë dikur një që ka bërë këtë, këtë. Ai ka qenë një, ka qenë në Këshill Bashkiak bashkë me grup demokrat dhe e keni votuar edhe ju ato vendimet. Kështu që, për figurat e njerëzve që kanë kontribuar për Durrësin, nuk është mirë me fol mbas tetë vjetëve.

Denisa Luarasi: Faleminderit zonja Kola.
Atëherë kalojmë votim.
Me 30 vota pro, 1 abstenim dhe 6 kundër miratohet dhe pika 3 e rendit i ditës pa ndryshime.

- I jepet fjala për projekt-vendimin **e pikës 4**, Komisionit të Rregullores dhe Çështjeve Juridike, zonjës Joniada Musaraj.

Joniada Musaraj: Atëherë, edhe pikën 4 ne e votuam dhe i kërkojmë këshillit sot që t'i japi votën pro. Faleminderit.

Denisa Luarasi: Faleminderit, zonja Musaraj.
E merr fjalën Komisioni i Buxhetit, Financës dhe Taksave-Tarifave, z. Rolant Xhelilaj.

Rolant Xhelilaj: Para se të jap opinionin e komisionit, desha të them vetëm shkurtimisht. Përgjigjen për atë fjalimin e zotit Muka, ia dha votimi edhe për integritetin e atyre drejtuesve që kanë qenë në vite.
Për pikën katër, komisioni votoi unanimisht pro dhe e kalon në këshill bashkiak për miratim.

Denisa Luarasi: Faleminderit, z. Xhelilaj.
Komente, pyetje ka për pikën 4 të rendit të ditës?.....
Kalojmë në votim....
Me 37 vota pro miratohet pa ndryshime edhe pika 4 e rendit të ditës.

- I jepet fjala për projekt-vendimin **e pikës 5**, Komisionit të Rregullores dhe Çështjeve Juridike, zonjës Joniada Musaraj.

Joniada Musaraj: Atëherë dhe për pikën pesë, ne si komision i kërkojmë këshillit sot që të japi votën pro. Faleminderit.

Denisa Luarasi: Faleminderit, zonja Musaraj.
E merr fjalën Komisioni i Buxhetit, Financës dhe Taksave-Tarifave, z. Rolant Xhelilaj.

Rolant Xhelilaj: Edhe komisioni jonë e kalon për miratim në Këshill Bashkiak pikën 5.

Denisa Luarasi: Faleminderit, z. Xhelilaj.
Komente, pyetje ka për pikën 5 të rendit të ditës?.....
Atëhere kalojmë në votim....
Me 37 vota pro, miratohet dhe pika 5 e rendit të ditës pa ndryshime.

- I jepet fjala për projekt-vendimin **e pikës 6** Komisionit të Rregullores dhe Çështjeve Juridike, zonjës Joniada Musaraj.

Joniada Musaraj: Atëherë dhe për pikën 6, ne si komision votuam pro dhe ftojmë këshillin që ta miratojë sot. Faleminderit.

Denisa Luarasi: Faleminderit zonja Musaraj.
Komisioni i Barazisë Gjinore Mirëqenies Sociale dhe Mosdiskriminimit, zoti Florian Tahiri.

Florian Tahiri: Atëherë edhe ne për pikën 6, komisioni jonë u mblodh dhe si gjithmonë e miratuam në unanimitet.

Denisa Luarasi: Shumë faleminderit, z. Tahiri.
Pyetje, kemi komente për pikën 6 të rendit të ditës?.....
Nuk ka. Kalojmë....
Me 37 vota pro miratohet dhe pika 6 e rendit të ditës pa ndryshime.

- I jepet fjala për projekt-vendimin **e pikës 7** Komisionit të Rregullores dhe Çështjeve Juridike, zonjës Joniada Musaraj.

Joniada Musaraj: Edhe për pikën 7, ne votuam pro dhe ftojmë këshillin që ta miratojë sot. Faleminderit.

Denisa Luarasi : Shumë faleminderit, zonja Musaraj.
E merr fjalën Komisioni i Buxhetit, Financës dhe Taksave-Tarifave, z. Rolant Xhelilaj.

Rolant Xhelilaj: Edhe komisioni jonë e kalon këtë pikë për miratim në mbledhjen e Këshillit Bashkiak.

Denisa Luarasi: Shumë faleminderit zoti Xhelilaj.
Komisioni i Mbrojtjes Civile, Sigurisë Publike, Emergjencave Civile dhe Shëndetësisë, zonjës Xhiliola Doçi.
Ju lutem mikrofoni.

Xhiliola Doçi: Komisioni i Mbrojtjes Civile dhe Shëndetësisë u mblodh dhe miratoi kalimin e pikës 7 për votim në Këshill Bashkiak. Faleminderit.

Denisa Luarasi: Shumë faleminderit zonja Doçi.
Kemi komente pyetje për pikën 7 të rendit të ditës?

Flutura Kasa: Kam unë...

Denisa Luarasi: Po ja japim Flutrës përpara.
Respektojmë.....
Flutra, të lutem, për...
O Flutra, ishit përnjëherë dhe ishte..... okej.
E kërkuat njëkohësisht dhe të respektova ty si grua.
Okej, okej, vazhdojmë.

Flutura Kasa: Okej.
Atëherë, për koecidencë, dy javë më parë kam pasur kontakte me drejtorin e, kryeinspektorin e Policisë Bashkiake, sepse më është dukur shumë i vogël numri i policëve, që shërbejnë në gjithë territorin e Durrësit dhe, të them të drejtën, mu bë qejfi kur erdhi kjo shtesa, por mu duk numri shumë i vogël. Sepse të llogaritësh numrin e qytetarëve të Durrësit, them se të paktën numri duhet të jetë te 150 punonjës. Megjithatë, hollësitë për financat, e këto i dinë më mirë drejtuesit e bashkisë, por unë kam të drejtë të them mendimin tim që më duket shumë i vogël numri i 20 punonjësve të Policisë Bashkiake, sepse dihet që problematikat në Durrës janë të mëdhaja dhe sidomos në sezonin turistik duhet një numër më i madh i punonjësve. Dhe në zonat e thella nuk kam parë shumë në qarkullim punonjës të Policisë Bashkiake. Kaq kisha.

Denisa Luarasi: Faleminderit zonja Kola.
Po Luan, mund ta kërkosh.... Kliko 5-n, pastaj…

Luan Nezha: Përshëndetje grupi!
Pika shtatë, vota ime është kundër për vetë arsyen, sepse besoj dhe kolegët tonë këtu në Këshill Bashkiak, sidomos në Njësitë Administrative Sukth, Manzë, Ishëm, është zero prezencë e Policisë Bashkiake. Ndoshta ndonjëri nga këtu dhe stafi i bashkisë mund ta mendojë si diçka që e kemi numrin, i kemi këto dhe ato të tjerat, pastaj janë gjërat e bashkisë. Po të bëhet trafik sot në njësitë administrative Sukth, Manzë, Ishëm dhe mos të jetë prezent minimalisht katër ose pesë policë të bashkisë, nuk ka sens dhe duke qenë që...

Joniada Musaraj: Po, prandaj po duhen më shumë...

Luan Nezha: Por ta mbaroj, kolegë.

Denisa Luarasi: Ne po i shtojmë, s'po i heqim.

Luan Nezha: Dhe unë them: këto 20 punonjës a janë mjaftueshëm për t'i mbuluar këto njësi? Se është sipërfaqe goxha e madhe, sepse nga këtu dhe njësitë bashkiake Ishmi është pothuajse bashkia me territorin më të madh dhe, duke qenë, është dhe gjë tjetër që Bashkia e Durrësit është te pesë bashkitë më të mëdha në Shqipëri dhe përsëri do të kemi sezon tjetër të verës tjetër, që do të jetë prapë problem qarkullimi. Patjetër që nuk e ka rolin dhe funksionin tërësisht Policia Bashkiake, po patjetër që u vjen në ndihmë edhe policisë së qarkullimit rrugor. Faleminderit.

Denisa Luarasi: Faleminderit.
Po, po Çuni. Ju lutem thërrit mikrofonin.

Llesh Çuni: Meqënëse kolegu përmendi shërbimet që ofron bashkia me policinë bashkiake nëpër njësi administrative. Nuk e di sa të dhëna ekzakte ka për Sukthin dhe Ishmin, por për Manzën gabon kur flet. Unë jam prezent atje herë pas here dhe policia Bashkiake e Manzës është prezente në Manzë përsa i përket disiplinimit të automjeteve që parkojnë vend pa vend në territorin që nuk e mbulon Drejtoria e Transportit Rrugor, apo edhe për probleme të tjera të shumta.
Kështu që për mendimin tim të bardhës t'i themi e bardhë, të zezës e zezë. Jo se ka qenë zero, ka prezencë të vazhdueshme të policisë bashkiake në njësinë administrative Manzë. Verifikojeni po të doni.

Denisa Luarasi: Faleminderit z.Çuni**.**
Jo, nuk bëri replikë, të lutem.

Luan Nezha: Kolegu Llesh me të drejtë mund ta mendojë që Manza, por po ta shikojmë qendra e Manzës gati 2 km janë në vijë që ka, kurse Sukthi nis në autostradë dhe përfundon në.... Edhe tek hapësira rrugore përllogaritja e trafikut është se sa hapësirë kalojnë makinat, kurse në Manzë është qendër e vogël. Pastaj rruga, pastaj nga qendra Manzë deri në kufij të Shkafanes është anë tjetër.

Denisa Luarasi: Përderisa përmende Manzën të ktheu përgjigje për Manzën.

Luan Nezha: Jo Lleshi bëri replikë për t'i bërë qejfin Partisë Socialiste. Po fakti është se dhe vetë Lleshi rrin në trafik. Faleminderit.

Denisa Luarasi: Apsolutisht, S'ka lidhje fare.
Faleminderit juve.
Po Muka.

Ardian Muka: Atëherë për fat të keq neve vazhdojmë edhe flasim me perceptim. Pra, siç kurse dhe kolegët e ngritën problemin. Mendojmë që janë pak, po mendoj që mund të jenë më shumë. Natyrisht për këtë punë ka statistika. Statistikat si nacionale, por edhe ndërkombëtare që neve mund t'i referoheshim. Kini parasysh që Durrësi me një popullsi rreth 360.000 banorë ka 80 policë bashkiakë, pra rreth 4.500 persona që duhet t'i mbulojë një policë bashkiak dhe duke pasur parasysh atë fashën e shërbimeve që këto duhet të japin dhe policimit, pra që duhet të kryejnë që janë rreth 15 pika, që ju na i keni rreshtuar këtu në relacion. Me thënë të drejtën sot do prisja dhe duhet të kishim këtu për të gjykuar mbi baza shkencore analitike duhet të kishim një relacion nga ana e policisë bashkiake ku t'u thonte që : gjatë vitit të fundit neve kemi kryer kaq policime, kemi në shërbim të ambientit, në shërbim të personave me nevojë, në shërbim të gjithë normativave të kontrollit që neve kemi kryer, sa gjoba kemi vënë, sa ndëshkime kemi bërë dhe sa konsultime kemi bërë me pjesën e qytetarëve dhe të bizneseve në qytetin e Durrësit, gjë të cilën ne nuk e kemi. Duke mos pasur këtë lloj kërkese dhe nga informacionet që kemi, që na u referua edhe në

komision ku edhe drejtori, drejtuesi i policisë bashkiake nuk e ka firmosur kërkesën për këto 20, sepse normalisht ai pretendon dhe kërkon më shumë.

Denisa Luarasi : Është firmosur.

Ardian Muka: Qeka firmosur sot. Okej. Kërkon pra një personel më të madh. Por, për të arritur aty ku kështilli të gjykojë, ku ne të vendosim dhe të gjykojmë që po, këtu duhet të merren jo 20, po 50 apo 100 policë të tjerë, duhet të kemi një raport, duhet të kemi një analizë të punës që është kryer, duhet të kemi dhe një analizë nga ana e bashkisë që, për këto 15 motivet që ne kemi këtu, neve kërkojmë një shtesë për kaq.
Çfarë ndodh? Të gjithë jemi dëshmitarë që ditën e inaugurimit të shkollës, nga Torra deri te, ku fillojnë te pista, në çdo anë të rrugës kishte nga dy policë bashkiakë që ndalonin trafikun. Pra, aty janë pesë vija të bardha, pesë komplete vija të bardha, nga 10 policë, domethënë, shërbejnë aty. Pse? Realisht, Durrësi ka një karakteristikë që gjatë verës ka shumë ngarkesë. Popullsia dy-trefishohet dhe, natyrisht, shërbimi që duhet të japi Policia Bashkiake është shumë më i madh dhe, nga ana tjetër, gjatë dimrit popullsia reduktohet në atë çfarë qyteti është realisht dhe ndoshta numri bëhet më i madh. Të gjithë jemi koshentë që ne nuk mund të marrim shërbim part-time. Pra, shërbimi duhet të jetë full-time. Por, ajo që them është: kjo punë nuk mund të bëhet me afrofe. Kjo punë ka nevojë për një analizë. Kjo punë ka nevojë për një raport nga ana e Policisë Bashkiake.

Denisa Luarasi: Po, shumë i qartë.

Ardian Muka Për atë që ne të vendosnim. Prandaj, mënyrën se si ka ardhur kërkesa dhe për mënyrën se si këtu ne po diskutojmë, shpreh votën kundra kësaj, këtij relacioni që ka ardhur dhe rritjes me vetëm 20 policë bashkiakë. Faleminderit.

Denisa Luarasi: Ok. Muka atëhere kalojmë votim.
Me 29 vota pro, 1 abstenim dhe 7 kundër miratohet pa ndryshim dhe pika 7 e rendit të ditës.

- I jepet fjala për projekt-vendimin **e pikës 8** Komisionit të Rregullores dhe Çështjeve Juridike, zonjës Joniada Musaraj.

Joniada Musaraj: Atëherë dhe për pikën 8 ne votuam pro dhe ftojmë këshillin që ta miratojë sot. Faleminderit.

Denisa Luarasi : Faleminderit zonja Musaraj.
E merr fjalën Komisioni i Pronave Publike, Transportit dhe Trafikut Rrugor zoti Hekuran Markola.

Hekuran Markola: Faleminderit.
Komisioni i Pronave Publike, Transportit dhe Trafikut Rrugor në unanimitet e kalon për votim në Këshill Bashkiak.

Denisa Luarasi: Faleminderit zoti Markola.
Komente, pyetje ka për pikën 8 të rendit të ditës?
Po Muka.

Ardian Muka: Në, për fat të keq, e them që para dy vitesh, kur na sollët këtë projektvendimin për bërjen me pagesë të rrugëve kryesore të qytetit, gjithashtu dhe të parkimeve dhe shesheve, thamë që jemi vonë, por nuk jemi gati. Fakti që ne kthehemi pas dy vitesh dhe nuk jemi akoma gati, tregon që ne kishim të drejtë kur e votuam kundër para dy vjetësh projektvendimin, që ju na sollët. Fakti që sot sillet për ndryshim ajo çfarë ju miratuat në atë kohë, na jep të drejtën prapë që ne thamë : që nuk jemi gati. Jemi vonë, por nuk jemi gati.

Denisa Luarasi: Mbarove.

Ardian Muka: Materiali që ka ardhur është një material i plotë, për të thënë të drejtën. Ka plotësuar shumë difekte, të cilat nuk ishin në kohën kur ju e aprovuat. Është një material, i cili jep sqarime edhe për shumë pikëpyetje që qytetarëve i ngelën dhe neve në atë kohë na ngelën të pamarra përgjigje dhe prandaj e votuam kundër.
Por thashë, sot e kësaj dite, ne nuk jemi gati, sepse nuk mund të fillosh nga tarifa dhe pastaj të mendosh për shërbimin. Përpara se qytetarëve të kërkohet të paguajnë, bashkia duhet të bëjë transparencë: kapacitetet reale të parkimit, mënyrën e funksionimit të skemës dhe ku do shkojnë pastaj të ardhurat e mbledhura. Durrësi ka nevojë për më shumë vende parkimi dhe më pak kosto reale për qytetarët. Pra, në momentin që ne të kemi parkimet publike dhe kjo bëhet në kuadrin e një analize që ne sot nuk e kemi, ku të thuhet që, ne po i japim qytetit kaq parkime publike. Pra, qytetarët kanë mundësi që, përveç asaj shërbimit që mund të marrin duke lënë në rrugë pa pagesë për atë orarin e darkës, apo që me 10.000 lekë të reja mund ta lënë gjithë vitin, edhe në ambientet, edhe në vendet ku është me pagesë, apo mund ta lëmë pa pagesë në sheshet e pallateve, të cilat kësaj radhe janë përcaktuar dhe janë saktësuar. Duhet që bashkia t'i jepte mundësinë e parkimeve publike që, për fat të keq, ne për momentin, ndërmjet shesheve dhe një parkimi që është stacioni i trenit, gjithsej në Durrës kemi vetëm katër. Kur shpërndarja të jetë uniforme në qytet, atëherë ne mund të shkojmë dhe t'u kërkojmë qytetarëve këtë çfarë juve na keni kërkuar dhe propozuar dhe kaluar me forcën e kartonit para dy viteve. Dhe këtë rast, ne do vazhdojmë ta votojmë kundër, në mënyrë që bashkia të reflektojë për të gjithë këto propozime që ne kemi dhënë, për përmirësimin e asaj çfarë duhet që qytetarët të marrin një shërbim më të mirë.
Faleminderit.

Denisa Luarasi: Okej, faleminderit.

Hekuran Markola: Të bëj një sqarim.

Denisa Luarasi: Po.

Hekuran Markola: Faktikisht dua të bëj një sqarim nisur nga rrjetet sociale, që disa që bëjnë si të ditur, dezinformojnë qytetarët për kartën e rezidentit, që e paraqesin sikur kushton 10 mijë lekë.

Ajo nuk është karta e rezidentit, ajo është aboneja, që është një mundësi tjetër, që në fakt Tirana nuk e ka, që mund të parkojnë edhe në rrugët ku është me tarifën 100 lekë apo 40 lekë ora.
Kështu që karta e rezidentit është falas dhe jo me 100 mijë lekë të vjetra, siç paraqitet.

Denisa Luarasi : Po faleminderit Markola.
Po kryetare.

Emiriana Sako: Mirë, unë në fakt desha që të sqaroja pak këshilltarin Muka, të sqaroja në sensin, të japim një, të bëjmë një debat, le të themi. Ju e dini shumë mirë që ne nuk bëjmë dot asnjë veprim pa vendimin e Këshillit, që do të thotë, me marrjen e vendimit të Këshillit për iniciativën për disa rrugë në qytet, të cilat janë rrugë kryesore, akse kryesore të qytetit, që jo detyrimisht lidhen me banorët, me banimin. Pra, ato nuk janë rrugë në të cilat parkojnë vetëm njerëzit që jetojnë aty. Me miratimin e vendimit ne fillojmë të gjithë procedurat e mënyrës se si do të realizohet. Patjetër që ka marrë kohën e vet, që nga ngritja e sistemeve, përzgjedhja e operatorëve, marrja e informacioneve nga Autoritet e Konkurrencës, pra kemi bërë një sërë hapash, të cilat janë detyrime ligjore, por edhe për ta bërë këtë vendimmarrje që të funksionojë autonome, pa pasur shtesa të buxhetit, me nxjerrjen e njerëzve në territor, por që të jetë automatike, elektronike. Kjo periudhë ka shërbyer pikërisht që të bëhen sistemet se si do të funksionojë parkimi dhe ajo që ne sjellim sot është një detajim i atij vendimi, që vjen si nevojë e evidentimit të të gjitha shesheve publike, të cilat do të përdoren për rezidentët.
Pra, në materialin e dorëzuar ne kemi detajuar sheshet në këto zona ku ka parkim me pagesë, sheshet ku do të parkojnë banorët brenda lagjeve dhe kemi detajuar dhe mënyrën se si do të pajisen me dokumentet, pra rruga që do të ndiqet për marrjen e dokumentit të kartës së rezidentit. Këto kanë qenë pjesë e vendimit të parë. Edhe karta e rezidentit ka qenë pjesë e vendimit të parë. Edhe abonimi mujor për makinën e parë ka qenë pjesë e vendimit të parë. I kemi detajuar me harta dhe me zona, në mënyrë që pas këtyre ne të përkthejmë në buxhet vendosjen e sinjalistikës dhe informimin e qytetarëve. Që do të thotë, gjatë kësaj kohe do të bëjmë pajisjen e këtyre, janë rreth 100 sheshe, rreth 100 sheshe brenda objekteve të blloqeve të banimit, të cilat do të pajisen me sinjalistikën përkatëse, ku duhet të parkojnë të gjithë. Pra, do të jetë një vend i rezervuar, le të themi, për banorët. Banorët që të kenë mundësi që ta përdorin këtë parkim dhe të monitorohen nga Policia Bashkiake dhe të mos marrin gjoba duhet që të pajisen me kartën e rezidentit, të cilën ne do ta shpërndajmë. Pra, edhe atë e kemi të miratuar në vendimin e Këshillit Bashkiak, me numër serial, me lagje. Pra, kemi bërë një detajim nga rajonet, i kemi kthyer në lagje, në mënyrë që pjesa më e madhe e rrugëve, pra rrugët që me pagesë ndodhen në rajonin një dhe dy, le të themi, dhe rajonin tre. Dhe, duke qenë se të mos ta lëmë kaq të gjerë që një banor që është pjesë e rajonit 1, që banon në lagjen 1, të parkojë dhe në lagjen 11, duke bërë një kakofoni, le të themi, me ata banorë që banojnë në lagjen 11, e kemi detajuar me lagje edhe me zona, siç e keni ju materialin në këshill.
Me këtë proces lidhet edhe shtimi i burimeve njerëzore në Policinë Bashkiake, që ne kemi vendosur që të vendosim një numër relativisht të vogël. Ne nuk mund të ecim me mentalitetin që një qytetar ka nevojë për një polic nga mbrapa, qoftë për të kaluar rrugën, qoftë për të ndaluar atë që shkel rregullat në kalimin e vijave të bardha apo për atë që parkon gabim. Policia Bashkiake është gjithë kohës në terren. Kemi pasur një sezon të ngjeshur, është fokusuar kryesisht në pjesën e zonave turistike dhe mendojmë që kjo strukturë që ne shtojmë me këtë vendim, së pari, nuk

rëndon buxhetin e bashkisë, automatikisht taksapaguesit, sepse numri është relativisht i vogël. Pastaj, në qoftë se do kemi nevoja për të rritur këtë numër, patjetër që do të vijmë prapë në Këshill me argumente, për të shpjeguar a duhen miratuar shtesa apo nuk duhet miratuar shtesa. Në rast se ky numër do të ishte 150, siç thoni ju, prapë ju do të kishit diskutimin që bashkia po fryn strukturat para zgjidhjeve. Jemi të sigurtë se na ka ndodhur, na ka ndodhur sa herë kemi bërë ndryshime të strukturave apo shtesë numrit të punonjësve. Kështu që, për të qenë transparent, mendojmë që ky numër është... Është e vërtetë që Policia Bashkiake ka kërkuar një numër më të madh. Ne mendojmë që ky numër është i mjaftueshëm për të filluar dhe të operuar në terren, për të përmirësuar situatën e parkimeve. Nga ana tjetër, thoni që s'ka alternativa, kemi bërë, kemi ndërtuar parkimin e ri tek hyrja e Portit. Sigurisht që një qytetar, i cili banon në lagjen 4, që parkon tek rruga paralel me Portin apo tek rruga "Egnatia", kur ka një parkim pa pagesë, nuk shfrytëzon, nuk përdor parkimin e ndërtuar, që mund ta ketë 5 minuta apo 10 minuta më afër. Ne e kemi sjellë këtë si nevojë, sepse qyteti i Durrësit është qyteti që ka numër më të madh të mjeteve në Shqipëri. Ka një trafik, i cili vjen çdo vit në rritje, sidomos në sezonin turistik. Dhe, për të vazhduar dhe planin me parkimet, kemi dhe plane të tjera për të bërë parkim në zonën e Muzeut të Dëshmorëve, ku jemi drejtuar Fondit Shqiptar të Zhvillimit dhe ata kanë hartuar projektin për të bërë parkim nëntokë, atje ku është sot sheshi përpara hyrjes. Pra, që është një parkim publik, le të themi, për të realizuar atje një parkim nëntokë, i cili do t'i shërbejë dhe kemi objektivin për të ndërtuar dhe një parkim nëntokë në shëtitoren "Taulantia". Sigurisht që këto nuk bëhen dot brenda një viti. Janë investime të rëndësishme. Janë investime që kërkojnë një buxhet, të cilin me Fondin Shqiptar të Zhvillimit ne mendojmë që do ta vijojmë bashkëpunimin edhe me projektet e tjera që kemi realizuar. Por nuk mund ta pranoj që ju thoni që këto vijnë si propozime të rastësishme dhe të pastudiuara, sepse sigurisht që ka një plan afatgjatë. Qytetarët me të drejtë kërkojnë zgjidhjen sot, por investimet e kësaj natyre, me vlera të kësaj natyre dhe ndërhyrje në territor, të cilat kanë një kompleksitet, qoftë në ndërtimin e objekteve nëntokë, por edhe në gjithë procedurat e pronave, pajisjes me leje ndërtimi, zonave arkeologjike, të cilat shtrihen kryesisht në qendrën e qytetit të Durrësit, kanë afatet e tyre për t'u zbatuar.

Kështu që ky material vjen si një detajim i materialit të parë. Ne do të bëjmë edhe do të publikojmë dhe të gjitha modelet se si do të orientohen qytetarët në faqen e bashkisë. Pra, do të japim disa shembuj. Në qoftë se një qytetar banon në sheshin Oslo, lagjja 8, po them, dhe ka dy makina, për njërën makinë do të ketë të drejtë që të marrë një abone me 100 mijë lekë të vjetra në vit dhe të parkojë në të gjitha rrugët, të cilat janë me pagesë. Makinën e dytë do duhet ta përdorë pa këtë, pa këtë abone, le të themi. Dhe këtë e kemi bërë për të dekurajuar përdorimin e mjeteve, shumë mjeteve nga e njëjta familje.

Pjesa tjetër që është e rëndësishme, ne do të... kërkesat për abonent do të bëhen pranë njësive administrative, me një listë dokumentacioni, të cilën ne kemi pasur dhe në vendimin e parë dhe në vendimin e dytë. Dhe këto do të afishohen, në mënyrë që qytetarët të kenë informacion. Do të trajtohen nga një njësi që do të jetë brenda Bashkisë së Durrësit, pra do të jepen lejet dhe do të tërhiqen po në njësinë administrative. Mbetet sfidë monitorimi i këtyre shesheve, se ne kjo është dhe edhe pak çështje kulture. Ne shohim shumë nëpër Durrës që parkojnë mbi trotuar. Shohim shumë nëpër Durrës që ka makina, të cilat janë të parkuara aty prej vitesh. Kemi bërë dhe një njoftim me Policinë Bashkiake. Kemi lënë afat për të hequr nga rrugët makinat, të cilat janë aty të amortizuara apo që kanë zënë vendet dhe, me të drejtë, ato makina sot nuk gjobiten dot nga Policia Bashkiake, sepse sot operimi me pagesë në këto rrugë nuk ka filluar. Disa qytetarë na janë

përgjigjur, disa jo, por kjo patjetër që kërkon dhe ndërgjegjësim, kërkon edhe një angazhim qytetar nga të gjithë për të respektuar hapësirat e njëri-tjetrit.
Pak a shumë, kjo ishte ideja e gjithë procedurës, të cilën unë e shpjegova në mënyrë të përgjithshme. Ne kemi shumë kërkesa nga qytetarët, se si do të operohet. Këto do t'i bëjmë transparente në faqen e bashkisë nëpërmjet rrjeteve sociale, por dhe ju patjetër do ta merrni këtë informacion dhe keni të drejtë të informoni gjithë qytetarët që ju drejtohen dhe ju pyesin se si do të operojmë. Mendojmë që do të jetë një proces, i cili do të sjellë, do të ketë vështirësitë e veta. Do të ketë vështirësitë e veta, patjetër, por do të sjellë avantazhe për bashkinë, sepse do të sjellë të ardhura, do të ketë eficiencë në përdorimin e këtyre hapësirave, sepse një person nuk ka pse të qëndrojë me orë, dy apo tre orë, kur konsumon një kafe në rrugët kryesore të qytetit, por do të kufizojë kohën që do të qëndrojë mjeti aty.
Të gjithë ata që do të zgjedhin që të vijnë me automjete për të punuar, pagesën do ta kenë, se kemi dhe këtë pyetje: a do të marrin rezident, do të marrin abone ata që kanë punën, pra banojnë përshëmbull në lagjjen 14 dhe punojnë në qendër të qytetit? Ata do të kenë të drejtë të marrin abone për të paguar jo tarifën ditore, por tarifën vjetore për konsumimin. Në fund të fundit, është një territor që i konsumohet bashkisë dhe qytetarëve, patjetër. Pra, në rrugët kryesore ne kemi makina të cilat zgjedhin që të vijnë, mund t'i lënë makinat dy-tre ditë atje, apo një që ka një dyqan e zë parkimin me një mjet, i cili e parkon aty dhe e lë kur merr furnizimin e radhës. Këto nuk janë situata normale dhe ne mendojmë që kjo do të zgjidhë disa problematika, plus faktet që ne do të kemi disa të ardhura më tepër, të cilat patjetër do t'i shfrytëzojmë, si fillim, duke pasur prioritet parkimet, por do t'i përdorim këto të ardhura dhe në sektorë të tjerë që janë shumë të rëndësishëm për bashkinë e Durrësit, në bazë të dakordësisë edhe vendimeve që do të kemi të miratuara nga Këshilli. Faleminderit.

Denisa Luarasi: Shumë faleminderit zonja kryetare.

Ardian Muka: Faleminderit zonja kryetare për sqarimin.
Natyrisht ajo që them dhe vazhdoj ta përsëris është që jemi vonë. Kur them jemi vonë për fat keq thashë, erdhëm te ato që neve kemi thënë, jemi dy vjet me vonesë dhe unë parashikoj që neve kur të bëhemi efektiv të kemi parasysh që duhet një periudhë shumë e gjatë sensibilizimi përsa i takon njerëzve informimi, sensibilizimi për të gjitha këto që neve po flasim këtu imagjinojeni që njerëzit do fillojnë, neve po na pyesin nga momenti që janë vënë pesë tabela nëpër Durrës edhe është bërë vizimi që ka filluar, nuk ka filluar, jemi vonë. Fakti që neve nuk kemi parkimet publike, fakti që ne nuk kemi parkimet publike gati, Tirana e bëri, e bëri, por pasi ngriti pesë apo gjashtë parkime të mëdha publike, duke i dhënë mundësi banorëve apo rezidentëve apo jo, që të kenë mundësi për një zgjidhje alternative, jo patjetër atë 1000 lekshin te rruga apo 100 mijë lekë të vjetra si abone vjetore, por edhe abone nëpër parkimet e mëdha, siç është rasti i parkimit që është tek hyrja e Durrësit, tek stacioni i trenit.
Monitorimi është një proces shumë i vështirë. Jam dakort me atë që thoni ju. Nuk zgjidhet thjesht me elektronikë. Me elektronik do zgjidhet thjesht pjesa e pagesave nëpër rrugë, por ndërkohë që monitorimi nëpër lagje do jetë diçka e vështirë dhe prandaj ne mendojmë që ato 20 policët, që kërkohen nuk janë të mjaftueshëm. Mund të jenë të mjaftueshëm për qytetin e Durrësit, për 20 lagjet e Durrësit, por kini parasysh që ka shumë shërbime të tjera që këto duhet të japin edhe nëpër nëpër vende të tjera në qytet, sidomos në pjesën e komunave nga problematikat që ngelin.

Pyetje do ishte dhe sugjerim që : a ka ardhur koha që bashkia e Durrësit të ketë nja dy karrotreca? Sepse me këtë zhvillim që neve do bëjmë, pra futjen në sistem të pagesës së rrugëve dhe shesheve me pagesë do ketë shumë problematika, duke filluar nga lëvizja e mjeteve që kanë vite, siç e thoni dhe ju, që rrinë nëpër rrugë pa paguar taksa dhe pa paguar asgjë, kanë zënë hapësirat publike, por edhe shumicën e.... E sidomos gjatë stinës së verës kemi parasysh bllokimin e parkimeve dyerve kryesore, parkimeve private, zënien e hapësirave nëpër dyqane apo jo të personave të papërgjegjshëm. Ndërkohë që kur thërrasim policinë apo kur thërrasim shërbimet edhe të bashkisë ngrejnë, policia bashkiake ngrejnë duart sipër, sepse thonë nuk e kemi ne këtë mundësi. E para s'kemi pjesën e, e mund të vendosim thjesht një gjobë, por që ta marrim ta zhvendosim këtë nuk kemi mundësi. Faleminderit.

Denisa Luarasi: Faleminderit zoti Muka.

Emiriana Sako: Një përgjigje për pjesën e karrotrecit. Vjet në dhjetor të vitit 2025, pra, Këshilli ka miratuar buxhetin dhe në buxhet është pjesë edhe vlera e karrotrecit për Policinë Bashkiake. Jemi në proces, brenda vitit 2026 mbyllet procedura. Mbetet dhe këtu sfidë vendi se ku do të jetë destinacioni, se ku do të qëndrojnë këto makina. Do të përdorim asetet tona. Jemi duke bërë një vlerësim aktualisht të aseteve tona që kemi në Shkozet apo në Spitall, apo Porto Romano, për hapësirat, pronat e bashkisë, le të themi, që aty mund të bëhet depozitimi i mjetit për një periudhë 72-orëshe. Por, sigurisht që mjetet e amortizuara kërkojnë një procedurë tjetër që është e përcaktuar në ligj dhe, me institucionin e pronave të konfiskuara jemi duke negociuar për përdorimin e ambienteve që mund të kenë ato në Durrës, do preferonim, por edhe jashtë qytetit të Durrësit, në mënyrë që kjo të jetë dhe një pikë grumbullimi që mund të përdoret. Dhe, në bazë të ligjit, ato mjete pastaj kalojnë një proces të caktuar, kalojnë për skrap ose i kthehen pronarëve, në bazë të ligjeve, që janë në fuqi, le të themi. Kështu që edhe këtë informacion tashmë e keni. Është miratuar vjet dhe jemi në procedurën për blerjen e tij.

Denisa Luarasi: Shumë faleminderit kryetare.
Po, Joniada.

Joniada Musaraj: Atëherë rrëmujshëm kolegu shpreh pyetje, mendime. Të jem e sinqertë, hera e parë që nuk e kam kuptuar absolutisht as pyetjen, as mendimin, as sugjerimin. Mua më vjen keq që kolegu i trajton qytetarët durrsak si të paaftë dhe të paformuar dhe të pashkolluar dhe pa eksperiencë jete për të lexuar një vendim, për të kuptuar një procedurë dhe për ta zbatuar atë. Kolegu, nëse do ishte kaq i paqartë ka patur kolegen dje në komision. Edhe unë kam patur pyetje për përfaqësuesit e bashkisë në lidhje me parkimin dhe dy zonja të nderuara të bashkisë kanë qenë prezent dje në komision dhe janë përgjigjur çdo pyetje që ne kemi patur për parkimin.
Dhe nga ana teknike është e vërtetë që dhe unë ndoshta s'i kam kuptuar fillimisht, por që të thuash sot jemi vonë, ka një problem që ju kurrë nuk jeni gati. Ky është problemi juaj. Ju s'keni për të qenë ndonjëherë gati! Jo, më të jeni gati për parkimin e për ndonjë projekt tjetër, që ne kemi në mend e s'jua themi, do jua themi më mbrapa. Kështu që sot nuk jua kemi sjellë këtë pike, që të thoni ju prapë jeni vonë, por jua kemi sjellë që të reflektoni dhe njëherë mbase ndryshoni.
Të votosh kundër nuk është çështja i kemi ne votat apo jo, zoti Muka? Problemi është që kur vjen një pikë dhe ke paqartësi, unë i drejtohem përfaqësuesve të bashkisë dhe kur marr përgjigje dhe

nga përfaqësuesi i bashkisë dhe nga kryetarja e bashkisë dhe sërisht apriori në tym votoj kundër, kjo është papërgjegjshmëri që ju keni si forcë politike ndaj qytetarit. Nuk është çështje se votohet apo jo në këshill një pikë, por kjo është papërgjegjshmëri dhe unë sot po e nxjerr dhe po ta them, sepse të mos duash të dëgjosh përfaqësuesin e bashkisë kur ke pyetje, nëse do kishe pyetje reale, teknike do i drejtoheshe atyre. Tani ti thua unë s'e di, po as nuk dua të di. Nuk do. Thjesht ju nuk doni. Kaq. Faleminderit.

Denisa Luarasi: Faleminderit zonja Musaraj.

Ardian Muka: Mu përmend emri.
Jo, zonja Musaraj.
Për fat të keq, nuk zënë mend. Ja kam sugjeruar që mos ta përmendë emrin, le të thotë kolegu, por e ka. Atëherë, meqë përmendi emrin, besoj që me kryetaren u sqaruam dhe fakti që ajo përgjigj gjithë atyre problematikave që unë ngrita, me një bisedë shteruese, tregon që jemi kuptu me kryetaren. Pjesa e votimit është, që fakti që ky proces rikthehet pas dy vitesh për t'u plotësuar, rikthehet për t'u komplementuar me shumë detaje dhe, të them të drejtën, unë ia thashë edhe në fjalën time që e përgëzoj sektorin që është marrë me këtë dhe me zonjën që ishte dje në komision, i shpreha këto konsiderata. Fakti që thashë bëhet pas dy vitesh tregon që, falë presionit tonë pozitiv, keni reflektuar. Fakti që duam të votojmë prapë kundër këtij është, që ne të shkojmë deri në fund në realizimin e asaj çfarë është. Pra, t'i japim shërbimin sa më të mirë qytetarëve, me sa më pak kosto për ata.
Natyrisht, bashkia duhet të mbledhë të ardhura, se me ato të ardhura ne do t'i kthejmë në investime. Nga ana tjetër, qytetarët duhet të kenë mundësinë të parkojnë, të jenë komodë, mos të kenë varavingo për të gjetur një vend parkimi dhe nga ana tjetër, mos t'i bëhet kosto ky proces. Faleminderit.

Denisa Luarasi: Faleminderit, zoti Muka.
Kalojmë në votim për pikën 8 të rendit të ditës.
Me 29 vota pro dhe 7 kundër miratohet pa ndryshime dhe pika 8 e rendit ditës.

- I jepet fjala për projekt-vendimin **e pikës 9** Komisionit të Rregullores dhe Çështjeve Juridike, zonjës Joniada Musaraj.

Joniada Musaraj: Atëherë dhe për pikën 9, ne si komision votuam pro dhe ftojmë këshillin që ta miratojë sot. Faleminderit.

Denisa Luarasi: Faleminderit zonja Musaraj.
Komisioni i Buxhetit, Financës dhe Taksave-Tarifave, z. Rolant Xhelilaj.

Rolant Xhelilaj: Edhe komisioni jonë e miratoi pikën 9-të dhe e kalon në mbledhjen e këshillit për miratim.

Denisa Luarasi: Faleminderit zoti Xhelilaj.
Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike, zonja Marsida Feshti.

Marsida Feshti Edhe Komisioni i Strehimit dhe Shërbimeve Publike është dakord që pikën 9 të kaloj për votim në këshill. Faleminderit.

Denisa Luarasi: Shumë faleminderit zonja Feshti.
Komente pyetje ka për pikën 9 të rendit të ditës?...
Nuk ka. Kalojmë votim.
Ju lutem ka mbetur dhe një pa votuar. Shikoni monitorin.
Me 35 vota pro miratohet dhe pika 9 e rendit të ditës pa ndryshime.
Kryetare doni fjalën?

Emiriana Sako: Jo

Denisa Luarasi: Atëherë ju falenderoj shumë për prezencën.
Mbledhjen e deklaroj të mbyllur.
Faleminderit.

Ky procesverbal mbyllet me nr. rendor 22 (njëzet e dy) faqe, i cili pasi verifikohet firmoset nga drejtuesja e seancës (Kryetare e Këshillit Bashkiak), *sekretarja i këshillit dhe 3(tre) këshilltarë.*

Mbajtëse e procesverbalit: Loranda Cani

Komisioni i Verifikimit të Procesverbalit :

Drejtuese e seancës (Kryetare e Këshillit Bashkiak) :	DENISA LUARASI
Sekretare e Këshillit Bashkiak :	DORINA MILJA
Këshilltare (Zv/kryetar i Këshillit) :	MIRELA SHALA
Këshilltari (Kr. Grupi) :	LUAN NEZHA
Këshilltari (Zv/Kr. Grupi) :	SAMI OSMANI